

## **AKTI I THEMELIMIT I SHOQERISE**

### **“RCF INDUSTRIES”sh.p.k.**

Ne Durres, sot me date 23.03.2022, me ane te ketij dokumenti te hartuar ne 2 (dy) kopje origjinale, une :

#### **ORTAKU I VETEM THEMELUES :**

**RCF S.p.A.** , shoqeri italiane, e regjistruar ne regjistrin e ndermarrjeve te Dhomes se Tregtise, Industrise, Artizanatit dhe Bujqesise te Rexho Emilias, Itali, me numer Repertori Ekonomik Administrativ RE-249658, me kod fiskal dhe numer regjistrimi 04081310965, me seli ne Itali, Rruga RAFFAELLO SANZIO 13 REGGIO EMILIA, e perfaqesuar sipas Vendimit te marre nga Shoqeria date 14 Shkurt 2022 nga Presidenti i saj dokt. Alfredo Macchiaverna lindur ne Castrignano del Capo (LE), me 16/02/1940, mbajtes i kartes se identitetit nr. CA 13233JJ

Deklaroj se themeloj shoqerine **“RCF INDUSTRIES” sh.p.k**

#### **KREU I**

##### **Neni 1**

#### **Dispozita te Pergjithshme**

Shoqeria **“RCF INDUSTRIES” sh.p.k.** është person juridik i se drejtes shqiptare, e organizuar ne formen e nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar dhe si e tille do te ushtroje aktivitetin e saj tregtar ne perputhje me dispozitat e Statutit te shoqerise dhe ne perputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare” dhe legjislacionit shqiptar ne fuqi.

##### **Neni 2**

#### **Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e aktivitetit te shoqërisë është e pacaktuar.

##### **Neni 3**

#### **Objekti**

Shoqëria ka si objekt te veprimtarisë se saj:

Shoqeria ka per objekt te veprimtarise se saj ushtrimin e industrise se aparaturave elektroakustike, audio dhe video dhe ne vecanti ndertimin e amplifikatoreve, mikrofoneve, altoparlanteve, videoprojektoreve, video-pajisjeve per impiantet audio-vizive, sistemet e komunikimeve, radiotelefonave, dhe aksesoreve qe lidhen me to, si dhe projektimin dhe instalimin e sistemeve te perforcimit dhe difuzionit audio dhe video, projektimin, realizimin e prototipeve dhe prodhimin e objekteve dhe pajisjeve prej druri. Shoqeria do te mund te kryeje tregti te pajisjeve

elektroakustike, audio dhe video, te amplifikimit, te regjistrimit dhe riprodhimit, duke perfshire edhe pjese te shkeputura prej tyre. Shoqeria do te kryeje aktivitet edhe ne ofrimin e sherbimeve, duke perfshire perpunimin e te dhenave nepermjet kompjuterit, ndaj shoqerive te kontrolluara dhe te lidhura me te.

**Neni 4**  
**Selia**

Selia e shoqerise eshte ne adresen Durres, Lagjia Nr.3, Rruga: Ramazan Jella, prane Poliklinikes Qendrore, Pall. Teuta Konstruksion. Asambleja ka kompetencen te hape dege dhe zyra perfaqesimi te tjera dhe t'i mbylle ato nese e quan te nevojshme.

**KREU II**  
**KAPITALI THEMELTAR DHE KUOTA**  
**Neni 5**

Kapitali themeltar i shoqerise perbehet vetem nga kontribute ne para dhe eshte 180.000.000 (njeqind e tetedhete milion) Lekë. Ky kapital eshte i ndare ne 1 (nje) kuote me vlere nominative 180.000.000 (njeqind e tetedhete milion) Lekë dhe zoterohet ne masen 100% nga ortaku i vetem i shoqerise RCF S.P.A.

Ortaku me kerkese te Administratorit dhe ne perputhje me dispozitat ne fuqi te karakterit fiskal, ka te drejte te kryej pagesa apo te jape kontribute, ne kapital, ose financime ne favor te shoqerise, te cilat konsiderohen financime pa interes. Shuma e financuar, afati i kthimit dhe menyra e rimbursimit te tyre rregullohen me kontraten perkatese. Shumat e mesiperme mund te perdoren per te mbuluar humbjet ose transferohen direkt ne rritjen e kapitalit ne perputhje me vendimin e asamblese se ortakeve.

**KREU III**  
**TRANSFERIMI I PJESEVE NOMINATIVE TE KAPITALIT THEMELTAR**  
**Neni 6**

Kuota qe perben kapitalin e shoqerise eshte lirisht e transferueshme midis ortakeve te shoqerise.

**KREU IV**  
**ASAMBLEJA**  
**Neni 7**

Asambleja e Përgjithshme është organi me i larte vendimor i shoqërisë. Vendimet e saj merren ne përputhje me legjislacionin ne fuqi dhe me kete Statut dhe janë te detyrueshme. Ato protokollohen ne regjistër te veçante ne përputhje me ligjin. Asambleja ka te drejte te ushtroje ne çdo moment verifikime mbi Administratoret dhe te kontrolloje çdo dokument te shoqërisë. Ajo mund te urdhëroje apo te udhëzoje administratoret ne kryerjen e detyrës se tyre.

Asambleja ka keto kompetenca:

- Vendos për përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë dhe strategjive të zhvillimit, përfshirë edhe investimet kapitale;
- Vendos për ndryshimet e statutit;
- Mbikëqyr zbatimin e politikave tregtare nga Administratori/et, miraton buxhetin vjetor dhe raportet e ecures se veprimtarisë;
- Emeron dhe shkarkon Administratorin/et, likuiduesit dhe ekspertët kontabël të Miratuar, si dhe përcakton shpërblimet e tyre;
- Vendos për zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- Vendos për pjesëtimin e kuotave dhe/ose anulimin e tyre;
- Miraton Bilancet, pasqyrat financiare dhe raportet e eksperteve kontabel të miratuar;
- Miraton shpërdarjen e fitimit, nepermjet ndarjes së dividendeve ose vendos për kapitalizimin e tyre nepermjet zmadhimit të kapitalit;

### **Neni 8** **Menyra e Thirrjes së Asamblesë**

Asambleja thirret nga Administratoret ose nga ortaku i vetëm i shoqërisë, nëpërmjet një njoftimi me shkrim ose nepermjet postës elektronike (email).

Njoftimi me shkrim ose me email duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës dhe duhet t'i dërgohet të gjithë subjekteve të interesuar, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e Asamblesë.

Megjithatë janë të vlefshme edhe mbledhjet e Asamblesë që nuk janë thirrur si me sipër, nëse është i përfaqësuar i gjithë kapitali dhe nëse në mbledhje asiston Administratori dhe eksperti kontabël i miratuar (nëse ben pjesë në strukturën e shoqërisë).

Në Asamble duhet të marrin pjesë të gjithë ata që figurojnë të regjistruar në librin e ortakeve.

Ortaku ka të drejtën e votës në Asamble në proporcion me kuotën që zotëron në kapitalin e shoqërisë.

Ortaku mund të përfaqësohet vetë, ose nëpërmjet një personi të pajisur me prokurë, i cili nuk duhet të jetë administrator, apo ekspert kontabël i autorizuar ose vartës i vetë shoqërisë apo ndonjë shoqërie tjetër të kontrolluar prej saj. I takon Administratoreve të verifikojnë të drejtën e pjesëmarrjes për ortakun.

Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse Asambleja e përgjithshme merr vendim për vlerësimin e veprimtarisë së tij, shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij, ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria, dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

Asambleja drejtohet nga Administratori ose nga presidenti i Keshillit Administrativ dhe në mungesë të tij/tyre, pjesëmarrësit në mbledhje, me shumicë absolute të kapitalit prezent në sallë, zgjedhin një drejtues.

Asambleja emëron një sekretar edhe jashtë bashkësisë së ortakeve. Sekretari mban P/verbalin e mbledhjes i cili duhet të përmbajë:

- a) datën kur është marrë vendimi;
- b) identitetin e votuesve dhe kapitalin që ata përfaqësojnë;
- c) identifikimin e ortakeve pro, abstenues ose kundra;
- d) sipas kërkesës së ortakeve deklaratimet e tyre mbi vendimin e marrë;

Vendimi i Asamblesë duhet të nënshkruhet ortaku i vetëm i shoqërisë prezent në mbledhje dhe në mungesë të tij nga personi i autorizuar nga vetë ai, si dhe nga sekretari. Kur e parashikon ligji,

apo kur administratori e sheh te arsyeshme, P/Verbali i mbledhjes mbahet nga një noter i zgjedhur prej tij.

### **Neni 9** **Kuorumi dhe Vendimarrja**

Vendimet e Asamblesë qe merren me shumice te zakonshme, jane te gjitha vendimet e Asamblese per te cilat Ligji dhe Statuti nuk kerkojne nje shumice te cilesuar.

Vendimet qe merren me shumice te zakonshme jane te vlefshme nese ne mbledhje jane te pranishem ortaket (me te drejte vote) qe zoterojne me shume se 30 për qind të kuotave (Kuorumi). Vendimi konsiderohet i marre nese eshte vendosur me shumicen e votave te ortakeve pjesemarres. Ne rast se nuk arrihet Kuorumi i percaktuar, Asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Per Vendimet e Asamblesë qe merren me shumice te cilesuar, mbledhja eshte e vlefshme nese ne mbledhje jane te pranishem ortaket (me te drejte vote) qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te kuotave (Kuorumi). Vendimi konsiderohet i marre nese eshte vendosur me  $\frac{3}{4}$  e votave te ortakeve pjesemarres. Ne rast se nuk arrihet Kuorumi i percaktuar me siper, Asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Merren me shumice te cilesuar keto vendime:

- Ndryshimi i Statutit;
- Zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit;
- Riorganizimi (shendrrimi, bashkimi, ndarja) si dhe/ose prishja e shoqërisë,
- Shperndarja e fitimeve ose kapitalizimi i tyre;
- Percaktimi i politikës dhe mases se pagave dhe shperblimeve per cdo pozicion pune ne shoqeri, duke pershire edhe percaktimin e pages apo shperblimin e Administratorit, ekspertit kontabel te miratuar dhe likujduesve;

Asambleja e Përgjithshme me nismën e saj ose me kërkesën e ortakeve qe përfaqësojnë te paktën 5% te kapitalit themeltar, mund të vendosë nisjen e një hetimi të posaçëm për parregullsitë përgjatë veprimeve të themelimit të shoqërisë apo të ushtrimit të veprimtarisë tregtare. Hetimi kryhet nga një ekspert i pavarur i fushës.

### **Neni 10** **Zmadhimi i kapitalit themeltar**

Vendoset nga Asambleja sipas prashikimit te bere ne Statutin e shoqerise. Pas vendimit te asamblesë për zmadhimin e kapitalit, ortaku i vetem i shoqerise mund te kryeje zmadhimin e kapitalit ne para dhe ne natyre. Ne rastin e zmadhimit ne para brenda 30 ditëve duhet te bëjnë derdhjet respektive.

Ortaket qe kane votuar kunder zmadhimit te kapitalit nuk jane te detyruar te derdhin kete kontribut. Ne vend te tyre kete do ta bejne ortaket qe kane votuar pro zmadhimit, secili ne raport me kuoten qe zoteron ne kapitalin themeltar.

Pas pageses se kontributeve, administratori duhet te shenoje ne regjistrin e ortakeve rritjen e kapitalit themeltar dhe nenshkrimin e tij nga personat qe moren pjese ne zmadhim.

Administratori ose presidenti i Keshillit Administrativ duke u mbeshtetur ne ligj dhe pa autorizim paraprak te Asamblesë, mund t'i kërkojne llogari ortakes se vetme qe ka nënshkruar zmadhimin e kapitalit, për derdhjen e kontributeve brenda afatit te sipërpërmendur.

### **Neni 11** **Zvogëlimi i kapitalit**

Vendoset nga Asambleja sipas prashikimit te bere ne statutin e shoqerise, me pjesemarrjen e ortakeve qe perfaqesojne te pakten  $\frac{3}{4}$  e kuotave te shoqerise.

Kur vendimi i zvogëlimit te kapitalit nuk motivohet nga humbjet ne aktive, kreditoret e shoqërisë duhen njoftuar menjëherë.

Ata mund te kundërshtojnë vendimin pranë organeve gjyqësore.

### **Neni 12** **Transformimi**

Shndërrimi i shoqërisë ne shoqëri aksionere, behet mbas hartimit te raportit përkatës nga Administratori/et dhe miratimit nga Asambleja e Përgjithshme, Vendoset nga Asambleja sipas prashikimit te bere ne piken 3 te Nenit 10 te statutit te shoqerise, si dhe ne përputhje me nenet 228 dhe 229 te Ligjit "Për Tregtarin dhe Shoqëritë Tregtare". Është i pavlefshëm çdo transformim i shoqërisë ne kundërshtim me këtë dispozite.

### **ADMINISTRIMI** **Neni 13**

Administrimi dhe përfaqësimi i shoqërisë i besohet

1. Z. Luca Falcone lindur me 18.08.1986 ne Scandiano, Itali, qytetar italian, mbajtes i kartes se identitetit nr. AX 6035967, leshuar nga komuna e Reggio Emilias, Itali, e vlefshme deri me 18.08.2026;
2. Z. Stefano Morlini lindur me 12.01.1969 ne Reggio Emilia, Itali, qytetar italian, mbajtes i kartes se identitetit nr. CA 75879BC leshuar nga komuna e Reggio Emilias, Itali, e vlefshme deri me 12.01.2029
3. Z. Mauro Macchiaverna lindur me 24.11.71 ne Bolonja, Itali, qytetar italian, mbajtes i kartes se identitetit nr. CA96986EI, leshuar nga komuna e Reggio Emilias, Itali, e vlefshme deri me 24.11.2029

ne menyre te pavarur nga secili prej administratoreve.

Secili prej administratoreve mund te veproje individualisht dhe gezon kompetenca te njejta me administratorin tjetër.

Administratoret jane emeruar per nje periudhe jo me shume se 5 vjet, me te drejte rimerimi, me përjashtim ne rastet e dorëheqjes apo shkarkimit nga ana e Asamblesë.



Administratoret gezojnë kompetenca të pakufizuara për realizimin e objektit të veprimtarisë së shoqërisë, me përjashtim të atyre kompetencave që Statuti ia njeh Asamblesë së Përgjithshme.

Administratoret kanë të drejtën dhe detyrimin që:

- Te kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm të veprimtarisë tregtare të shoqërisë;
- Te zbatojnë politikën tregtare, të vendosura nga Asambleja e përgjithshme;
- Te përfaqësojnë shoqërinë tregtare përpara të tjerëve;
- Te kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- Te përgatisin dhe të nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë;
- Te përgatisin buxhetin vjetor të shoqërisë.
- Te përgatisin propozimet për shpërndarjen e fitimeve dhe t'i paraqesin këto dokumente përpara Asamblesë për miratim;
- Te krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- Te kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- Te raportojnë përpara Asamblesë në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe për realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- Te propozojnë dhe t'i paraqesin Asamblese për miratim strukturën organizative të shoqërisë, rregulloren e brendshme, organogramen dhe rregulloren e sigurimit teknik;

Administratoret kryejnë edhe detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut. Ata mund të vënë në lëvizje instanca juridike dhe administrative, duke emëruar avokate e duke lëshuar prokurë në rastet gjyqësore, duke kryer operacione bankare, këtu përfshirë edhe hapjen apo mbylljen e llogarive rrjedhëse, nënshkrimin dhe xhirimin e çeqeve, realizimin e tërheqjeve dhe derdhjeve me leke në dorë apo urdhër xhirimi, tituj krediti, paradhënie krediti.

Viti ekonomik fillon me 01 Janar deri me 31 Dhjetor çdo viti.

#### **Neni 14** **Përgjegjësitë e Administratorit**

Administratori është përgjegjës individualisht ose solidarisht ndaj shoqërisë ose të tjerëve për shkeljet ligjore të Statutit apo fajet kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Shoqëria nuk është përgjegjëse ndaj të tjerëve, për aktivitetet kryera nga Administratori në kundërshtim me kompetencat e tyre, kur vërtetohet se ata (të tjerët) ishin në dijeni të kësaj rrethane.



### Neni 15

Asambleja e përgjithshme mund ti shkarkojë Administratorit/et në çdo kohë me shumicë të zakonshme, duke dhene nje motivacion. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

### Neni 16

#### EKSPERTI KONTABEL I MIRATUAR

Emërimi i ekspertit kontabël te miratuar behet me vendim te Asamblesë, e cila përcakton mandatin dhe shpërblimin.

Kur ligji e parashikon shprehimisht prezencën e ekspertit kontabël te miratuar, janë te pavlefshme operacionet e kryera pa prezencën e tij.

Quhen si te permendura ketu te gjitha detyrimet qe permenden ne nenin 17 te statutit.

### KREU V

#### FITIMI DHE FONDET

### Neni 17

Fitimi qe do te shpërndahet përbehet nga fitimet e realizuar gjate vitit financiar te sapo mbyllur. Asambleja mund te vendose për formimin e fondeve te ndryshme dhe shpërndarjen e tyre.

### Neni 18

Asambleja pasi ka miratuar bilancin përfundimtar dhe ka vendosur shumën qe do te shpërndahet, përcakton pjesën e fitimit për secilin ortak ne raport me kuotën qe zotëron secili.

Shoqëria mund t'u shpërndajë fitime ortakëve, vetëm nëse Administratori, nen përgjegjësinë e tij personale, lëshon një certifikatë të aftësisë pagese, e cila konfirmon shprehimisht se shpërndarja e propozuar e dividendëve përmbush kërkesat nenit 77 te Ligjit "Për Tregtarin dhe Shoqëritë Tregtare"

Dividendët qe nuk korrespondojnë me fitimet e realizuara realisht, mund t'u reklamohen ortakeve qe i kane marre ato.

### KREU VI

#### PAVLEFSHMERIA, PRISHJA DHE LIKUIDIMI

### Neni 19

Statuti si dhe aktet e tjera te shoqërisë mund te konsiderohen te pavlefshëm, vetëm ne rast se shkelen dispozitat e parashikuara nga Ligjin Nr.9901, date 14.04.2008 "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare" ose nga Kodi Civil.

### Neni 20

Shoqëria mund te prishet vetem ne keto raste:

- me vendim të Asamblesë së përgjithshme;
- me hapjen e procedurave të falimentimit;




- nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
- me vendim të gjykatës.

**Neni 24**  
**LIKUIDIMI**

Kur me vendim gjykatë shpallet pavlefshmëria absolute apo relative e shoqërisë si dhe në rastet e parashikuara në statut, asambleja e përgjithshme vendos prishjen e parakohshme të shoqërisë dhe fillojnë procedurat e likuidimit që do të kryhen sipas kërkesave të parashikuara në Ligjin “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” dhe në përgjithësi nga legjislacioni shqiptar në fuqi.

**ORTAKU THEMELUES I SHOQERISE**

**“RCF INDUSTRIES”sh.p.k.**

A handwritten signature in blue ink, written over a horizontal line. The signature is cursive and appears to be 'Rafael Ruzhica'.